

Komentet e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së për median

17 Prill 2013

Q: Si do ta komentoni dorëheqjen e Z. Biba nga KQZ-ja?

Ambasadori Wollfarth: Shpresoj që KQZ-ja të vazhdojë të punojë me seriozitetin më të madh, siç ka punuar deri tani. Do të doja të theksoja që personalisht kam respekt të madh për punën e Z. Biba dhe për vendimin e tij. Për mendimin tim ai ka kontribuar ndjeshëm për një atmosferë konstruktive brenda KQZ-së që ka çuar në marrjen e vendimeve teknike të nevojshme për përgatitjen e zgjedhjeve të 23 qershorit. Do të doja ta lavdëroja punën e tij, së bashku me atë të kryetares dhe të anëtarëve të tjerë të KQZ-së. Jam i sigurt që do të ndihet mungesa e tij. Unë jam i bindur dhe i uroj gjithashtu që të ketë një të ardhme të mirë personale dhe profesionale të cilën e meriton.

Q: Zoti Wollfarth, në qarqet mediatike është thënë që ju keni dhënë dorëheqjen. Ka gjë të vërtetë në të?

Ambasadori Wollfarth: Po, njëra nga gazetatat kryesore kishte një artikull sot. Ju e dini, unë jam një diplomat gjerman dhe ky është viti im i tretë këtu. Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë më ka ofruar një post të mirë, i cili mund të konsiderohet edhe një ëndërr e shumë diplomatëve, dhe unë e kam pranuar dhe kjo do të bëhet brenda këtij viti. Ndërsa jam këtu ndoshta është e rëndësishme që të theksoj se do të jem këtu deri në fund të zgjedhjeve. Dhe ndoshta është me interes të sqarohet, meqë ka pasur edhe informacione çorientuese, se nuk jam unë personi që shkruaj raportin e ODIHR-it. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it do të vëzhgojë dhe të shkruajë raportin e tij dhe ata kanë një mandat më vete. Por do të jetë një punë nga secila palë sipas mandatit të vet, krah për krah, në shërbim të popullit shqiptar për mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Q: Zoti Wollfarth, mendoni se do të cenohen standardet zgjedhore me zhvillimet e fundit në KQZ-së.

Ambasadori Wollfarth: Shpresoj që të mos cenohen. Shqipëria fatmirësisht ka burime të mjaftueshme njerëzish të mirë që mund të punojnë profesionalisht në KQZ dhe në KZAZ. Por është shumë e rëndësishme që Shqipëria të bëjë më të mirën e vet, sidomos për ta mbajtur politikën sa më larg të jetë e mundur nga KQZ-ja, e cila duhet konsideruar si një organ apolitik. Është kënaqësi të punoj me popullin shqiptar; më pëlqen shumë. Ata dëshirojnë dhe aspirojnë të jetojnë në një vend demokratik dhe meritojnë një kuadër të mirë për këtë. Dhe unë synoj të jem pjesë e kësaj në procesin zgjedhor.

Q: Mendoni se dorëheqja e Zotit Biba do të ndikojë në punën e KQZ-së?

Ambasadori Wollfarth: Jam i sigurt që ai do të ketë një pasardhës, i cili shpresoj se do të ketë të njëjtin nivel të lartë profesional. Jam i bindur që KQZ-së do t'i duhet të vazhdojë të punojë në një mënyrë apolitike.

Q: A mendoni se është e balancuar KQZ-ja sot me raportin 4 me 3?

Ambasadori Wollfarth: Mesa kuptoj, kjo ka qenë tradita në vend gjatë dhjetë viteve të fundit, dhe është konsideruar – dhe kjo është shumë e rëndësishme – nga aktorët lokalë e balancuar ose mjaftueshëm e balancuar, por disa herë lipset një përshtatje më e mirë.

Megjithatë, shteti i së drejtës është i rëndësishëm. Ai nuk duhet anashkaluar. Në të njëjtën kohë mbetet shumë e rëndësishme që të ketë dialog në çdo fazë, ashtu si edhe një sens konsensusi dhe angazhimi për popullin shqiptar për të vazhduar me axhendën e reformave. Shpresoj që 23 qershori të sjellë një lloj qartësie që do të ketë shumicë të mjaftueshme dhe mjaft konsensus për të ecur përpara me axhendën e reformave. Shpresoj që të lemë pas kohën kur Shqipëria ngecte në diskutimet e saj të brendshme dhe që reformat të mund të adresohen dhe të ecet përpara me sukses. Kjo përfshin gjithashtu çështje të rëndësishme si ajo që trajtuam sot këtu në këtë seminar për luftën kundër krimit të organizuar, dhe që në këtë rast kishte të bënte me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe aspekteve financiare të tij.

Ju faleminderit.